



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 17.11.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 8,9,10 dhe 14.a të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, Përfundimit 01 nr. 06-79588 të miratuar përmes postës elektronike me dt: 04.11.2015, më të cilin është aprovuar mbështetja financiare e kërkesës së Klubit të Pingpongut "Vllaznimi" për organizimin e turnirit ndërkombëtar "Dita e Flamurit Kombëtar", me dt: 17.11.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Klubit të Pingpongut "Vllaznimi" nga Gjakova nr. 10-400-81121, për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e turnirit ndërkombëtar "Dita e Flamurit Kombëtar", që do të mbahet në Gjakovë me dt: 22.11.2015, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 500€.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 500€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe bartjen e tyre në konton e Klubit të Pingpongut "Vllaznimi" nga Gjakova nr. 1110337413000171 Pro Credit Bank .
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
 - Z. Albion Curri, anëtarë i kryesisë së Klubit të Pingpongut "Vllaznimi", Gjakovë
 - Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari- Lila